

Thirrja është e hapur nga data 20.02.2024 deri më 05.03.2024

TERMAT E REFERENCËS

FURNIZIMI ME LAPTOPË

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI"
Objektiva	Furnizimi me katër (4) laptopë

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Rom të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 4 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

2. RRETH PROJEKTIT

Aktualisht, "Nevo Koncepti" është pjesë e konsorciumit të përbërë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Karl Kuebel Stiftung (KKS), dhe Drejtësi Sociale (DS), Ky konsorcium ka filluar zbatimin e projektit "Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe në Shqipëri". Projekti përkrahët dhe financohet nga *Ministria për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim i Republikës Gjermane (BMZ), Karl Kuebel Stiftung (KKS) dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)*. Grupi i synuar në Kosovë janë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shtatë komunat më të mëdha të Kosovës. Ndërkaq, fokusi i projektit do të jetë në katër fusha: Arsim, Punësim, Shëndetësi dhe Hartim Politikash.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Kompletimi i dokumentacionit sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë.
- Ofertimi për furnizim me katër (4) laptopë, me specifika teknike minimale si më poshtë:
 - Intel Core i7-1165G7 (12MB, up to 4.70GHz, 4 Core),
 - 15.6" FHD (1920x1080) TN AG,
 - 8GB DDR4-3200,
 - 512GB M.2 PCIe 2242
 - Interl Iris Graphic,
 - WebCam, wi-Fi 5 2x2AC+BT
 - 3Cell (45Wh), 65W Adapter.

4. AFATI KOHOR

- Thirrja për ofertë është e hapur nga data 20.02.2024 deri më 05.03.2024 .

5. ÇMIMI

- Çmimet duhet të jepen në euro, duke përfshirë TVSH-në.

6. VLEFSHMËRIA E OFERTËS

- 90 ditë nga dita e përmbylljes së thirrjes për ofertim.

7. VLERËSIMI I OFERTAVE

- Do të vlerësohen ofertat e përcaktuara si thelbësisht përgjegjëse ndaj specifikimeve teknike.
- Do të zgjidhet kompania e cila ofron ofertën e vlerësuar si ekonomiksht më e favorshme dhe produktet e së cilës përbushin standardet e kërkesave teknike.

8. KRITERET E VLERËSIMIT

- Çmimi – max. 40 pikë
- Specifikimet teknike – max. 30 pikë
- Garancioni – max. 15 pikë
- Koha e furnizimit me paisje – max. 15 pikë

9. REZULTATET E PRITSHME

- Bashkëpunim i mirë në mes të furnitorit dhe kontraktuesit.
- Ofertimi sipas specifikimeve të kërkuara.
- Përbushja e afateve kohore të furnizimit.

8. PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

1. Kopja e regjistrimit të biznesit në ARBK me numër unik identifikues.
2. Informatat mbi biznesin .
3. Specifikimet teknike të produkteve.
4. Fotografi të produkteve.
5. Garancioni i paisjeve të ofruara.
6. Afati kohor i dorëzimit të paisjeve (Ofertuesit duhet të tregojnë çartë kohën e nevojshme që iu nevojitet për dorëzimin e paisjeve dhe dorëzimin në destinacionin final nga vetë kompania).
7. Oferta e nënshkruar dhe e vulosur në secilën faqe.
8. Periudhën e vlefshmërisë së ofertës.

9. MËNYRA E DORËZIMIT

Ofertat duhet të dorëzohen jo më larg se me datë **05.03.2024**, në formë elektronike apo fizike (kopja fizike duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur dhe të vulosur):

- Në adresën elektronike: anesaberisha@nevokoncepti.org, ku në cc duhet të jetë o.osmani@nevokoncepti.org.
- Në zyrën e Nevo Konceptit, me adresë: Rr. "Adnan Krasniqi", nr.149, hyrja II/18, 20000, Prizren.